



**AGJENCIA KOMBËTARE
PËR DIASPORËN**

Nr.128 Prot. Tiranë më, 20.11. 2018

**INSTITUTI KULINAR
“NERANXI”**

Nr.132 Prot. Tiranë më, 20.11. 2018

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

DHE

INSTITUTIT KULINAR “NERANXI”

PËR

PROMOVIMIN E KULINARISË SHQIPTARE NË

DIASPORË



Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Instituti Kulinar “Neraxi” (këtej e tutje referuar si "Palët"), të inkurajuar nga dëshira e përbashkët për të nxitur shkëmbimin e kulturave gastronomike në vendet pritëse të diasporës shqiptare;

Duke vlerësuar rëndësinë e kulturës gastronomike shqiptare si pjesë e identitetit kombëtar shqiptar që mund të përfaqësojë në mënyrë dinjitoze vendin;

Duke marrë parasysh politikat e ndjekura për forcimin dhe realizimin e lidhjeve të diasporës me vendin e origjinës si dhe përfaqësimin e vendit tonë në aktivitete kulturore ndërkombëtare;

Duke konfirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij memorandumi;

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum si më poshtë:

Neni 1

Palët me dëshirën për të zhvilluar aktivitete të përbashkëta për promovimin e kulinarisë shqiptare në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë, me qëllim ruajtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar janë dakorduar si vijon:

- a. Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin, në fushën e diasporës mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.
- b. Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe programeve për promovimin e kulinarisë shqiptare në diasporë.
- c. Palët do të zhvillojnë aktivitetin “Ditët e Kulinarisë në Diasporë” me qëllim promovimin e recetave gastronomike shqiptare në diasporë mbi bazën e programeve vjetore të miratuara nga palët.
- d. Palët do të angazhohen në programe vjetore të përbashkëta kulturore për diasporën kudo që do të vlerësojnë se është e nevojshme.

Neni 2

Shpenzimet financiare të aktiviteteve, do të përballohen nga Instituti Kulinar Neraxi.

Neni 3

Agjencia Kombëtare për Diasporën do të marrë përsipër lehtësimin e procedurave ligjore vendase dhe ofrimin e ndihmës për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve sipas këtij Memorandumi.



Neni 4

Palët kanë rënë dakord që ky memorandum nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit të cilat nuk janë specifikuar në të por janë në përputhje me objektivat e saj.

Neni 5

Mosmarrëveshjet e këtij memorandum do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve.

Neni 6

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Agjencinë Kombëtare për Diasporën dhe dy në Institutin Kulinar “Neranxi”.

Nënshkruar më 20.11.2018, në Tiranë në 4 kopje origjinale secila në gjuhën Shqipe i tërë teksti është i njëjtë.

PËR AGJENCINË KOMBËTARE

PËR DIASPORËN

PËR INSTITUTIN KULINAR

“NERANXI”